



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRRI	
02 Nr. / Br	1227 / 20
Nr. i Sq. / Br. st	
Data: / Datum	08.12.2020
VUSHTRRI - VUÇITRRI	

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA VUSHTRRI



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 67 “g” të Statutit të Komunës, Paragrafi 1, pika 1.1, nënpika 1.1.2 të Vendimit të Kuvendit Komunal 01 Nr.70/20 të dt.23.04.2020 për shpërndarje të mjeteve financiare nga subvencionet dhe transferet dhe në bazë të kërkesës së palës Nr.02-104/02-55754/20 të dt.03.12.2020, Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M

1. znj.Shkëlqesa Trepça nga Vushtrria, Koordinatore lokale e projektit “Ngritja e aftësive për punësimin e të rinjve” së bashku me OJQ “Rinia Aktive e Gjakovës”, i lejohen mjete financiare në shumë prej 700 € (shtatëqind euro), për mbështetje të projektit.
2. Shuma e mjeteve të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi duhet të paguhet nga Zyra e Kryetarit – fondi për transfere dhe subvencione.
3. znj.Shkëlqesa Trepça apo i autorizuari i tij ligjor duhet të ofroj kopjen e dokumentit të identifikimit dhe të kartelës bankare në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa në Vushtri me qëllim të implementimit të këtij vendimi.
4. Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Vushtri.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.




Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri

Vendimi ju dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Palës si dhe
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në vlerësimin profesional të komisionit, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Mjetet financiare në shumë prej 251,150.00 euro (dyqind e pesëdhjetë e njëmijë e njëqind e pesëdhjetë euro) të iu paguhen 513 bizneseve të komunës së Vushtrrisë të cilat janë dëmtuar ekonomikisht si pasojë e virusit COVID-19 në vitin 2020.
2. Mjetet financiare në shumën e cekur në pikën paraprake të paguhen nga fondi për ndihmë bizneseve të dëmtuara si pasojë e COVID-19, bazuar në listën përfundimtare të komisionit profesional në të cilën janë përfshira bizneset përfituese.
3. Pagesat të bëhen në llogaritë bankare të secilit biznes, të përfshira në listën përfundimtare.
4. Tabelorët për vlerësimin përfundimtar të përfituesve nga kjo ndihmë financiare janë pjesë e këtij vendimi të bashkangjitur në shtojcë.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRIN

02 Nr. / Br 1277/20

Nr. i fq. / Br. sh

Data: / Datum 11.12.2020

VUSHTRRI - VUČITRIN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturës numër 20-SHV01-002-121 datë 03.12.2020, në shumë prej 20.00 € (njëzet euro) në llogari të Hotel “Amazona”, Milloshevë, Obiliq, akomodim (bujtje një natë) e një poeteshe shqiptare pas mbajtjes së takimit “Ditët e Poeteshave Shqiptare – Vushtrria 2020”.
2. Pagesa e shumës së cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPSTINA VUCITRN	
02 Nr. / Br	1278/20
Nr. i fq. / Br. sh	
Data: / Datum	11.12.2020
VUSHTRRI - VUCITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturës numër VU/53-20 datë 09.12.2020, në shumë prej 16,790.00 € (gjashtëmbëdhjetë mijë shtatëqind e nëntëdhjetë euro) në llogari të Kompanisë së Sigurimit fizik "Commando" nga Prizreni me të cilën komuna e Vushtrrisë ka lidhë kontratë për sigurim fizik të objekteve shkollore.
2. Pagesa e shumës së cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i komunës, në njësitë buxhetore në të cilat ka mjete të lira.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Arsim.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.





Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Arsim
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës jep këtë:

U R D H Ë R E S Ë
PËR NDALIMIN E PËRDORIMIT TË MJETEVE PIROTEKNIKE

1. Ndalohet përdorimi i mjeteve piroteknike në vende të hapura publike (rrugë, trotuare, sheshe, vend parkingje etj.).
2. Ndalesa sipas pikës një (1) të kësaj urdhërese vlen nga data 23 dhjetor 2020 deri me datën 03 janar 2021.
3. Personat të cilët veprojnë në kundërshtim me këtë urdhëresë do të dënohen me gjobë konform legjislacionit në fuqi.
4. Për zbatimin e kësaj urdhërese obligohet Drejtoria e Inspektimeve e cila duhet të përcjellë zbatimin e kësaj urdhërese deri me kalimin e ditëve të festave të fund vitit përkatësisht datën 03 janar 2021.
5. Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit urdhërohet që mos të lëshoj leje për shitje të mjeteve piroteknike. Në rast se deri tani është lëshuar ndonjë leje e këtillë të bëhet revokimi i saj.
6. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe duhet të zbatohet menjëherë.


Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës

Dërgohet:

- Drejtorisë për Inspektime
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Arkivit të Sekretarisë